



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:264058

Datë: 05.02.2024

Numri i dokumentit: 05286417

**2023:264059**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Shpresa Hoxha, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.5/24 të datës 01.02.2024 e lidhur në zyrën e ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit L.Sh nga fsh...-Lipjan, dhe përfaqësuesit me autorizim të të dëmtuarës, Telekom i Kosovës Sh.A Prishtinë, R. B., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.1070/23 të datës 06.11.2023, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par.2 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim, më datën 05.02.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.5/24 të datës 2101.02.2024, e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit, L.Sh nga fsh...-Lipjan, dhe përfaqësuesit me autorizim të të dëmtuarës, Telekom i Kosovës Sh.A Prishtinë, R. B..

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1070/23 e datës 06.11.2023, dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit L.Sh nga fsh....-Lipjan, i lindur me datë ..., me nr. personal: ...2, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par.2 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën me nr. PP/II.nr.1070/23 të datës 06.11.2023, kundër të pandehurit L.Sh nga fsh...-Lipjan, për shkak të veprës penale, Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 357 par.2 të KPRK-së.

Në bazë të kësaj aktakuze, me dt.30.01.2024, gjykata caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar, me të cilin rast pas prezentimit të aktakuzës nga prokurori i shtetit Mimoza Sylahyseni, i pandehuri L.Sh dhe përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarës, Ramadan Bunjaku, janë pajtuar që lënda penale e evidentuar me nr. 2023:264059, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datë 01.02.2024, në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit, Nd.nr.5/24, në mes palëve në procedurë dhe atë në mes të pandehurit L.Sh dhe përfaqësuesit të dëmtuarës Ramadan Bunjaku

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**2023: 264059 datë, 05.02.2024**

Sekretarja Juridike,  
Shpresa Hoxha

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.